



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	249/16
Nr. i fq. / Br. st	- 6 -
Datas / Datum	29. 12. 2016
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCES VERBAL

NGA MBLEDHJA E -II- E JASHTËZAKONSHME E XII-A ME RADHË E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 16 DHJETOR 2016

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 16:10.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri:

Adnan Klinaku, Agim Bregaj, Agron Perçuku Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Habib Mustafa, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muhamrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Syzana Syla, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe përmarrje të vendimeve të plotfuqishme.

Kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Draft-Planit Zhvillimor Komunal i Komunës së Vushtrrisë 2016-2024.

Sami Istrefi, drejtor i DUMM-së-paraqiti një ekspoze lidhur me procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunalë, duke dhënë shpjegime për kuadrin ligjor në fushën e planifikimit urban si dhe dha sqarime sa i përket fushës së planifikimit të komunës në periudhën 2016-2024 konform normave të parapara me Planin Zhvillimor Komunalë.

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit- tha se duke e dëgjuar drejtorin i cili thotë se asamblistët nuk kanë marre pjese në debatet publike ,por i beje me dije se për një term të caktuar nuk është e nevojshme të marrim pjese dhjetë herë për të njëjtën term dhe po ja kujtoj drejtorit qe kom qenë pikërisht në debatin publik kur znj. Puka ta kishe tërhequr vërejtjen se Ligji për Planifikim Hapësinor nuk e njeh termin revidim. Tutej shtoi se kjo ditë është dashur të jetë një lloj festë për komunën, tone duke marr parasysh që sot do të diskutohet ndoshta edhe të miratohet dokumenti më i rëndësishëm i një komune. Një plan zhvillimor i një komune është dokument i cili jep perspektive të re një zhvillimi të qëndrueshëm, shfrytëzimin efikas të fondeve publike ,shfrytëzimin e përshtatshëm të tokës, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore dhe

natyrore. Zhvillimi i bujqësisë duhet të jetë synimi yni kryesor, tu e marr parasysh qe Vushtrria është një qytet i njojur me një traditë të prodhimtarisë bujqësore. Por që në këtë plan zhvillimor po ta lexosh vërehet çart se më së shumti ju keni përkushtuar ndërtimeve ,ndërrimi i destinimit të tokët bujqësore në atë ndërtimore e që për mua është e papranueshme. Dëshiroj qe t'ju jap disa kritika te cilat mendoj se janë teknike por me një rendësi te veçantë. P.sh. faqe 9, pika 1.3 thuhet: Informata për vendime dhe miratimet e kuvendit komunal në lidhje me PZHK. Ndërsa këtu janë futur edhe vendime e pëlgjime të cilat i ka dhënë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, propozoj që të përmirësohet ose të largohen vendimet që i ka dhënë ministria nga kjo pike dhe të futen në një pikë të veçantë. Pastaj ka ndodhë që të bëhet copy paste rregullore strategji por për një Plan Zhvillimor që është unik vetëm për një komunë të bëhet copy paste mendoj që kjo ndodhe vetëm tek ne. Me duket që këtë e hasa në faqe 100 dhe 105. Përveç këtyre gabimeve kamë hasur në faqe 83 nr 21 ku përmendet toke e shfrytëzuar për aeroport, dua te dijë a është bëre qyteti im me aeroport apo planifikohet të bëhet sepse nëse bëhet me kish gjëzuar mua dhe gjithë qytetaret e komunës. Meqenëse kam studiuar për mjekësi dhe nuk jam eksperte e kësaj fushe unë jam munduar që në konsultim me ligjin t'i çartësoj disa gjera dhe paraprakisht kërkoi falje nëse bëj ndonjë gabim eventual. Kërkoi një sqarim se a do të duhej që para miratimit te këtij plani zhvillimor në këtë kuvend të kemi edhe dokumente të tjera të miratuara paraprakisht sepse me Ligjin për Planifikim Hapësinor neni 11 pika 2 thotë se: autoriteti përgjegjës për planifikim dhe menaxhim hapësinor siguron që Plani Zhvillimor Komunal dhe Harta Zonale e Komunës përfshinë: pika.2.2 të gjitha planet rregulluese urbane dhe planet rregulluese të hollësishme të miratuara paraprakisht. Dhe si fillim do të ndërlidhem me disa rekomandime që janë dhënë në mbledhjen e jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa, duke shpresuar që këto propozime i ka bëre një drejtor dhe jo një anëtarë i kuvendi duke pretenduar qe t'ia marr të drejtat e kuvendit t'i dërgoj në drejtori kjo ndoshta se dikujt i ka konvenuar por absolutisht jam kundër dy propozimeve të dhëna në atë takim. Njeri ka të bëje me rekomandimin ku thuhet: nga ura e Silnices e deri tek tregu të jete zone ndërtimi me etazhitet 4-5 ndërsa rruga prapa te bankinat të rregullohet dhe tu jepet mundësi e barabartë për qasje në këtë rruge. Kaq mire e kanë menduar me iu bërë edhe rrugën atyre ndërtesave që planifikojnë me i ndërtuar. Dhe në mënyrë decidive jam kundër rekomandimit qe: tokat bujqësore, të cilat mbisin tokë ndërtimore t'i jepet mundësia Drejtorisë për Kadastër në mënyrë automatike ta ndërrojë tokën bujqësore në tokë ndërtimore në bashkëpunim me Drejtorin e Bujqësisë. Përveç që jam kundër dyshoj shumë që këtë e lejon ligji dhe ai që e ka bërë këtë propozim nuk e ka menduar si duhet. Po me intereson me e dite aty ku thuhet Zona e 8 prej ku deri ku përfshin kjo zone ,si është e mundur që prej stacionit të autobusëve e deri tek ura të jetë ndërtim, ndërsa vetëm një pjese të mbeten gjelbërim, cila është arsyja sepse aty planifikohen 4 milion investime dhe 200 qytetarë të punësohen. Më mire kishte me qenë që nga ura e Silnices e deri tek tregu te mbeten gjelbërim se ajo pjese.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit –kërkoi nga hartuesi i këtij plani që të jap sqarime lidhur me projektet e parapara në Planin Zhvillimor Komunalë. Pastaj shtoi se tek zona e tetë (8), pyeti se a do të mbeten ashtu siç ka qenë në vitin 2009, por me një ndryshim të vogël që shenja e stacionit të autobusëve të zhvendoset nga prona kontestuese të cila ligjërisht gjykata i ka shpallur me pronarë faktik, dhe në tekst të përshkruhet që stacioni i autobusëve të vendoset brenda zonës tetë (8). Lidhur me këtë çështje ai deklaroi se nuk është në gjendje që këtë ta votoj për faktin se nuk e din se deri ku është kjo zonë sa është sipërfaqja e saj, dhe se nuk munde të voton diçka për të cilën nuk ka njojuri dhe në situatën më të keq kur do të votoj diçka "ku më fund të ditës nuk do të dinte tu tregonë qytetarëve se për çfarë ka votuar". Tutje shtoi se ideja që të mbeten zona të gjelbërtë vendet e quajtura "Vneshtat" dhe tek vendi i quajtur "sheljet e Haxhi Musës " tha se këtë nuk e kupton dhe për këtë kërkoi sqarime. Planifikimi i ndërtimit të një ngrohtoreje, për këtë shtroj pyetjej për çfarë ngrohtoreje bëhet fjalë dhe kërkoi që kur të planifikohet diçka të jemi serioz dhe mos të bëhen investime dhe në fund të mos kemi rezultatet e duhura. Çështje të cilën e vlerësoi se shumë të dhimbshme dhe tragjike është

shkatërrimi i tokës bujqësore me ndërtime. Në këtë kontekst duke ju referuar ndërtimit të një fushë sportive në fshatin Doberllukë, pyeti se “kush guxon” të jap leje që në tokën e klasës së parë të ndërtoj fushë sportive. Pastaj ai vazhdoi duke theksuar se zyrtar të Drejtorisë së Urbanizmit pa e pyetur askënd dhe pa u konsultuar paraprakisht caktojnë trase të rrugëve dhe i orientojnë projektet e kanalizimeve dhe ceku rastin në fshatin Nadakoc ku ata kanë tentuar që në pronën private të Mehmet Ferizit të ndërtohet rrugë publike dhe për këtë ai ua tërhoqi vërejtjen këtyre zyrtarëve.

Sami Istrefi, drejtor i DUMM-së-paraqiti sqarime lidhur me diskutimet e anëtarëve të kuvendit duke u përgjigjur në pyetjet e tyre.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit – tha se në mbledhjen e kuvendit të muajit tetor të gjithë shefat e grupeve kuvendare kishin rënë dakord që materiali lidhur me PZHK-në të ofrohej në kopje fizike, dhe tani jemi është thirr kjo mbledhje e kuvendit ku materiali mungon përfaktin se CD të cilat na janë dërguar ato nuk po hapën. Andaj ai në emër të grupit kuvendar të LDK-së kërkoi që kjo mbledhje të shqyhet, që materiali të dërgohet në kopje fizike, me qëllim që ky dokument të analizohet mirë zonë për zonë dhe detal për detal dhe kështu ky planë të aprovohet me konsensus të gjitha partive politike kuvendare.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – tha se është lajm i mirë ardhja e planit Zhvillimor Komunal, por sa ky Plan Zhvillimor është me të vërtet për zhvillimin e Komunës sonë kjo mbetet të shihet. Ne kemi analizuar planin dhe fatkeqësisht pjesa më e madhe e këtij draft-dokumenti është konstatime e statistika, që nuk flasin për një plan të vërtetë zhvillimor. Unë, si anëtar i kuvendit komunal, por edhe si qytetar nuk kam parë që ka një qasje serioze gjithëpërfshirëse për të nxjerrë një plan vërtetë zhvillimor dhe që do t'i shërbente Komunës sonë në 8 vitet e ardhshme. Ai vlerësoi se thënë sinqerisht pjesa më e madhe është vëtëm konstatime e dëshira. Por, Komuna e Vushtrrisë situatën e ka tash të konstatuar dhe nuk ka nevojë për konstatime e dëshira, por për Plan Zhvillimor, pra për zhvillim. Në planin që na ka sjell sot ekzekutivi ka shumë informata e edhe shumë situata të dëshirueshme por realiteti është ndryshe. Ne, gjithmonë kemi mbështet planet e strategjitë që e nxjerrin Komunën e Vushtrrisë nga situata e varfërisë dhe ngecjes, por jo rrallë jemi zhgënjer sepse PDK-ja dhe përfaqësuesit e saj kur janë rezikuar interesat private e grupore asnjëherë se kanë kursyer as shkatërrimin e qytetit, e besa as orientimin e tij kah ato interesa. Prandaj, sot kemi nevojë më shumë se kurrë për plane e përpunë, për orientim të drejtë për qytetarin, e larg interesave të bizneseve e grupacioneve klanore-politike. Por kjo nuk ndodhë, sepse asnjëherë nuk pres ndryshim të situatës nga personat që e kanë krijuar vetë këtë situatë. Draft Dokumenti që kemi, ka element pozitiv, sepse të paktën na i sjellë disa informata, por nuk paraqet një strategji të qartë se cili do të jetë fati i Komunës së Vushtrrisë në 8 vitet e ardhshme. Ky dokument do të duhej të na tregonte se ku do të jemi pas 8 viteve. Për shembull: cilat do të janë drejtimet profesionale në shkollat tona që i përgjigjen zhvillimit ekonomik lokal? Si do të jetë gjendja e ambientit mjedisit në Komunën tonë? Sa do të arrijmë që ti përgjigjemi nevojave elementare të jetës së qytetarëve tanë? Cila do të jetë mirëqenia e qytetarëve tanë? Si do të sillemi me pasurit tona publike dhe private, kah do të orientohet bujqësia dhe a i përgjigjet trendeve kombëtare të rajonale, etj. etj. Pra ne nuk i pamë këto, i pamë në mënyrë periferike e pa analizë, të përmendura por jo të detajuara. Nëse keni paguar ekspertë për këtë plan atëherë është dashur që në detaje të specifikohen, të analizohen dhe të shkruhen. Ne si Lëvizje VETËVENDOSJE! do të donim që të kishim para vetës një Plan Zhvillimorë që i përgjigjet Komunës së Vushtrrisë për të cilin do të votonim pozitivisht, por ky fatkeqësisht nuk është ai plan, ky nuk është plani që i jep Vushtrrisë së ëndrrave tona, jetë. Ky është plan që e stagnon Vushtrrinë, plan që e vazhdon gjendjen me ndonjë ndryshim kozmetik por jo përbajtjesor, e Vushtrria ka nevojë për një plan përbajtjesor që e ndryshon atë. Prandaj, ne si Lëvizje nëse nuk vendoset të shtyhet ky plan pre t'u përmirësuar, do të votojmë kundër, duke i parë defektet që ka ky plan. Në fund ai shprehu shqetësimin e tij lidhur me zonën e tetë (8), ku siç vlerësoi se në Komitetin për Politikë dhe Financa është ardhur propozimi ku vëtëm një pronë ka qenë e gjelbër kurse

pjesa tjetër ka qenë pjesë ku janë lejuar ndërtimet, sot në plana parashihet që kjo zonë të jetë komplet zonë ndërtimi, ndërsa tani kërkohet që sërisht të kthehem i në vitin 2009 gjë e cila është e pakuptimit. Lidhur me këtë çështje ai kishte marrë informacione nga disa zyrtar komunal të cilët kishin dekluaruar se pas 3 apo 4 muajve zona e tetë (8) e paraparë me këtë plan sërisht do të trajtohet dhe kjo për mendimin e tij nuk është e arsyeshme, andaj vlerësoi se më mirë është të prite edhe 3 apo 4 muaj dhe të bëhet një plan funksional dhe për së mbari.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit –tha se kjo mbledhje e kuvendit nuk është dashur të thirret në mbrëmje por gjatë ditës në orar të punës kur edhe përqendrimi ynë është më lartë. Tutej shtoi se pajtohet por ishte edhe kërkesë që materialet për këtë dokument të dërgohen në formë të shkruar, sepse për ndryshe pajisje me material fizik të shkruar është detyrim statutar. Pastaj vetë koha kur po trajtohet ky dokument e ka devalvuar titullin e këtij dokumenti në lidhje me afatin 2016-2024, përfaktin se vitit 2016 i kanë mbetur vetëm edhe dy javë, andaj afati i këtij dokumenti duhet të jetë 2017-2025. Në vazhdim ai vlerësoi se ky dokument është i natyrës strategjike për komunën tonë dhe i njëjtë duhet të trajtohet në mënyrë të gjithanshme nga të gjitha grupet e interesit shoqëria civile dhe ekspertët. Mandej ai duke analizuar procesverbalin nga takimi me qytetar lidhur me PZHK-në ceku se ky material është dashur të lekturohet sepse i njëjtë ka shumë gabime gjuhësore. Me këtë planë duhet ti jepet prioritet mbrojtjes së tokës bujqësore dhe asaj që është nënë sistemin e ujites, ku duhet të orientohen kahet e ndërtimit andaj ku toka është e klasës më të dobët. Duhet ti kushtohet rëndësi çështjes hidrologjike të komunës me qëllim të mbrojtjes së qytetit nga vërsimet të cilat mund të janë shkatërruese. Pastaj vlerësoi se këto dhe shumë çështje tjera duhet të analizohen me kujdes dhe të trajtohen në mënyrën më të mirë pastaj ato të materializohen në këtë plan. Në fund tha se tani ky dokument në formën dhe momentin që po trajtohet sigurisht që parqet paragjykime, dhe propozo që materialet lidhur me këtë pikë të dërgohen në formë fizike dhe të mbahet një tjerët mbledhje ku do të shqyrtohej ky planë.

Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit –pasi adresoj kritika në lidhje me kohen e mbajtjes së mbledhjes, njoftoi se është kundër aprovimit të këtij plani pasi që vetëm në zonën e tetë (8) që parashihet në këtë planë po humbin rrëth 200 vende të punës nga investimet potenciale që do të bëhen, dhe se mungon vullneti politik për ndryshimin e këtij plani sepse parashihen që në atë pjesë të investohen rrëth 5,000.000 € nga kompania “Emona Citi”. Andaj kërkoi që kjo mbledhje të shtyhet dhe të ulen të gjitha partitë politike dhe ta diskutojnë këtë edhe një herë këtë planë.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit –tha se të gjithë duhet të jemi përgjegjës për angazhimet tona sepse mandati i tyre është marrë nga qytetarët dhe përgjegjësia e çdo anëtarit të kuvendit është për ta thënë të vërteten. Tutej shtoi se edhe herën e kaluar është shtyrë mbledhja për arsyet e mungesës së materialit të nevojshëm dhe përsëri edhe sot është e njëjta gjendje ku ky dokument me rëndësi për komunën nuk është përgatitur si duhet. Andaj ai shprehu opinionin e tij se nuk do të votoj për t’ia plotësuar dëshirën dikujt duke pasur mendim tjetër, dhe kërkoi që kjo mbledhje të shtyhet të përgatitet materiali në mënyrën më të mirë si dhe të kemi një konsensus politikë mes të gjitha partive për aprovin e këtij plani.

Ergin Sunguri, anëtar i kuvendit –tha se të gjithë jemi të interesuar të kemi një planë sa më të mirë. Dhe apelo tek të gjithë që edhe me planë por edhe me forma tjera të përkrahen biznese e komunës përfaktin se vetëm në këtë mënyrë mund të zhvillohet ekonomia e komunës sonë. Gjithashtu ai bëri vërejtje sa i përket përkufizimit të monumenteve kulturore dhe historike në veçanti ceku hamamin e qytetit, ku është cekur se hamami më herët ka qenë kishë dhe më vonë banjë romake.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës–tha se kjo mbledhje e kuvendit është dashur të transmetohet edhe përmes radio vicianumit me qëllim që të informohen të gjithë qytetaret. Tutej shtoi se përkushtimi për hartimin e këtij plani nuk ka munguar, dhe ceku se për këtë ka punuar në mënyrë profesionale një kompani e specializuar. Lidhur me diskutimet e anëtarëve të kuvendit vlerësoi se ky dokument është ardhur në kuvend për ta shqyrtuar dhe diskutuar dhe

kjo çështje është shumë mirë, pastaj ai ceku se nëse në këtë planë ka çështje diskutabile atëherë ato elemente le të votohen një për një në mënyrë të veçantë. Duke prekur disa nga pikat kryesore të cekur nga anëtaret e kuvendit ceku se disa nga propozimet e anëtarëve të kuvendit ishin absurde për faktin se nuk mund ta dallonin PZHK-në nga Plani Lokal i Zhvillimit Ekonomik. Mandej ai njoftoi se ky dokument, është shqyrtuar në KPF si dhe në Komitetin Konsultativ për Urbanizëm por edhe në disa grupe tjera. Propozimet që kanë dal nga këto takime janë të diskutueshme secila prej tyre mund të analizohet dhe secila prej tyre mund të votohet. Gjithashtu edhe propozimet e bëra nga Komitetit Konsultativ për Urbanizëm mund të diskutohen dhe në fund mund ta marrin aprovimin e kuvendin apo edhe të kundërt varësisht se si e vlerëson kuvendi këtë çështje. Lidhur me termin revidim njoftoi se ka qenë kërkesë e MMPH-së që Plani Zhvillimor Komunal mos të revidohet por të fillohet procedura për hartimin e një pani të ri konform ligjit të ri për planifikimin hapësinorë. Në vazhdim ai vlerësoi se edhe nëse një plan ka defekte atëherë më mirë është të ekzistoi se sa mos të kemi fare planë. Lidhur me disa prona në fshatin Dobërrillukë në të cilat që një kohë të gjatë janë duke u hedhur mbeturina, ceku se është menduar që në atë lokacion të ndërtohet një impiant për trajtimin e ujërave, pasi ajo lokalitet është pika më e ultë territoriale në komunën tonë. Lidhur me idenë për shtyrjen e mbledhjes së kuvendit, dhe që materiali të ofrohet në kopje fizike tha se për shkak të peshës dhe rëndësisë së këtij dokumenti pajtohet që mbledhja e kuvendit të shtyhet për një datë tjetër. Në fund ai si data orientuese për mbajtjen e mbledhjes së kuvendit për shqyrtimin e PZHK-së ceku datat 06.01.2017 apo 13.01.2017 si dhe apeloi tek të gjithë anëtarë e kuvendit që ta mbajnë një takim të përbashkët joformal ku do të analizohej PZHK-ja para se ai të procedohet për kuvend për aprovim.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit –tha se përkrah idenë për zhvillimin e zonës industriale në lokacionet mbi rrugën magjistrale, por edhe fushat sportive të bëhen në atë pjesë me qëllim që të ruhet toka e bukës. Si dhe është i mendimit që të mbahet një takim i veçantë për analizimin e Planit Zhvillimor Komunal.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit –tha se edhe herën e kaluar kishte shprehur vullnetin që ky dokument të aprovohet me konsensus të plotë politikë. Pastaj shtoi se interesimi për të marrë pjesë në debate për PZHK-në ka qenë i vogël, dhe ceku se nëse ndokush ka vërejtje për këtë dokument atëherë është mirë që ato ti paraqes me shkrim përfaktin se nëse vazhdohet kështu atëherë do të shkojmë deri në pafundësi. Në vazhdim ai ceku se duhet të kemi një analizë të gjithanshme për këtë dokument dhe se duhet të gjendet një modus i përbashkët nga të gjithë ne dhe jo tanë të shtyhem i njëri me tjetrin për gjëra që nuk i kontribuojnë askujt e sidomos qytetarit tanë. Mandej vlerësoi se nëse dikush din se ndonjëri ka ndonjë konflikt të interesit lidhur me këtë dokument atëherë është mirë që ajo të bëhet e ditur këtu në kuvend.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –tha se pasi që është kërkesë që kjo mbledhje e kuvendit të shtyhet dhe që materiali të ofrohet në kopje fizike atëherë le të mbetet kështu por, ai shprehu dyshimet e tij se edhe pas të gjitha këtyre prapë do të kemi të njëjtin debat dhe të njëjtin përfundim. Mandej të gjitha përgjegjësit për bllokimin e këtij procesi do ti faturohen kuvendit të komunës, kurse kur bëhet fjalë për tokën bujqësore vlerësoi se të gjithë jemi për ndalimin e ndërtimit të tokës bujqësore. Mirëpo askush nuk ka kërkuar që toka bujqësore të shndërrohet në tokë ndërtimore por është kërkuar që nga 150 në dy anët e rrugës magjistrale të lejohen ndërtimë për zhvillimin e bizneseve, por kjo bllokadë nga ana e kuvendit nuk i kontribuojn zhvillimit të biznesit. Lidhur me zhvillimin e debati për PZHK-në tha se e përkrah një ide të tillë dhe kërkoi që ky dokument të kompletohet dhe të procedohet me materialet e mbledhjes së rregullt të kuvendit e cila do të mbahet me datën 29.12.2016.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit –propozoi që të mbahet një mbledhje e veçantë për shqyrtimin e PZHK-së me datën 06.01.2017 ose me 13.01.2017.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –tha se është mirë që të gjitha propozimet që vijnë nga anëtaret kuvendit të bëhen në formë të shkruar dhe të njëjta të dërgohen në Sekretarin e

Kuvendit apo në Drejtorinë e Urbanizmit dhe të vlerësohen nga Zyra Ligjore si dhe të njëjtë pastaj të procedohen në KPF dhe kuvend.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit – propozoi që materiali për PZHK-në tu dërgohet anëtarëve të kuvendit dy javë ditë më përpara, kurse propozimet të shkojnë një java para thirrjes së mbledhjes.

Në fund të diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:


Shtyhet mbledhja e kuvendit për një datë tjerët, duke u marrë përbazë propozimi i Kryetarit të Komunës që si data orientuese përmblajtjen e kësaj mbledhje të kuvendit jenë data 06 apo 13 janar 2017, si dhe që materiali lidhur me Planin Zhvillimore Komunal të dërgohet në kopje fizike.

Mbledhja përfundoi në orën 17:40.

Bastri Duraku


Procesmbajtës

Shpëtim Zhegrova


Kryesues i Kuvendit